

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil,** sipas gjyqtarit Halil Zahiri, me s. juridike Shefinaze Sahiti, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditësit PTK,, , sipas të autorizuarit, R.B, jurist nga Gjilani, ndaj të paditurit, E. Sh, nga Gj, rr..., për pagesën e borgjit, në seancën kryesore dhe publike të mbajtur në mungesë të të paditurit më dt.30.05.2017 bie këtë

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET si e bazuar,** kërkespadi e paditësit PTK, ndaj të paditurit, E Sh, nga Gjilani dhe **DETYROHET** i padituri që t ia paguajnë paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 105,44 €, për pagesën e borgjit, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, me vërejtje të përmbartimit të detyruar, /nuk është kërkuar kamata dhe shpenzimet e procedurës/.

**II. DETYROHET** i padituri t ia paguajnë paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 15,00 €, në emër të pagesës së taksës sgjyqësore.

## **A r s y e t i m**

Paditësi, PTK, sipas të autorizuarit, R.B, në padi-kërkesëpadi /propozim për ekzekutim/ dhe në seancën kryesore e publike të mbajtur më dt.30.05.2017, në mungesë të palës së paditur kishte deklaruar se i padituri, E. Sh, nga nuk ia kishte paguar shumën e të hollave në lartësi prej për pagesën e borgjit, lidhur me shfrytëzimin e nr. ..të telefonit fiks.

I autorizuari i paditëses, jur. nga gjykatës i propozoi ta aprovoi në tërësi padinë si të bazuar dhe të detyrohet i padituri t ia paguajnë paditësit borgjin në shumën prej 105,44 €, nuk e ka kërkuar kamatën dhe shpenzimet e procedurës përveq pagesën e taksës gjyqësore.

I padituri, për seancën gjyqësore të dt.30.05.2017, ishte ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën e kishte pranuar më dt.20.04.2017, nuk kishte prezentuar në seancë dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar, ndërsa pala paditëse gjykatës i ka propozuar që të mbahet séanca kryesore në mungesën e të paditurit.

Gjykata ka vendosur të mbahet shqyrtimi në mungesën e të paditurit, ndërsa në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat si vijoi:

- Lexohet dhe administrohen, faturat muajit, Tetor, Nëntor e Dhjetor të vitit 2008, faturat e muajit, Janar, Shkurt, Mars, Prill dhe Maj të vitit 2009. Nga këto prova gjykata konstatoi se i padituri i ka mbetur borgj paditëses shumën prej 105,44 €.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses deklaroi se në tërësi mbetet pran padisë-kërkespadi, i propozoi gjykatës që kërkespadi ta aprovoi si të bazuar, të detyrohet i padituri t ia paguaj paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 105,44 €, për pagesën e borgjit në emër të shërbimeve për shfrytëzimin e numrit fiks, nga PTK me seli në Prishtinë, dega në Gjilan.

Paditësja nuk i ka kërkuar pagesën e kamatës dhe shpenzimet e procedurës, përveq pagesës së taksës gjyqësore në lartësi prej 15 €.

Gjykata themelore në Gjilan në bazë të provave të administruara të cekura më lart dhe deklaratës së të autorizuarit të paditëses e ka vërtetuar gjendjen faktike se i padituri nuk ia ka paguar paditëses shumën e të hollave në lartësi prej 105,44 €, në emër të shërbimeve postare lidhur me shfrytëzimin e numrit të telefonit fiks.

Në bazë të nenit 151 pika a, b dhe c. konfirmohet se i padituri është ftuar në mënyrë të rregullt, nuk iu ka përgjigjur ftesës për seancë gjyqësore, mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata konsideroi se në bazë të fakteve dhe provave bashkangjitur në padi, vërtetohet se ekziston themelsia e kërkesëpadisë dhe janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të bie Aktgjykim për shkak të mungesës.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 151 pika a, b dhe c, të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 452, të LPK-ës, shpenzimet e procedurës, pagesës së taksës gjyqësore i bart pala e paditur.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Gjyqtari**  
Halil Zahiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, në afat prej 7. ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara, përmes kësaj Gjykate.

